

VENDIM
Nr.573, datë 14.7.2010

**PËR TRAJTIMIN ME USHQIM, PA PAGESË, TË EFEKTIVAVE TË GARDËS
SË REPUBLIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtimin me ushqim, pa pagesë, të efektivave të Gardës së Republikës, sipas mënyrës dhe kategorive të poshtëshënuara:

a) Me një vakt (drekë) ushqim, efektivat që shërbejnë në strukturat operuese të Gardës së Republikës.

b) Me tri vakte ushqim, njësia e ndërhyrjes së shpejtë, grupet e gatshme, të cilave, për natyrë të veçantë pune, shërbimi u zgjat më shumë se koha normale e punës.

c) Me tri vakte, i gjithë efektiv i Gardës së Republikës, për rastet e kalimit në gatishmëri.

2. Strukturat, numri sipas strukturave dhe normat e trajtimit me ushqim, për çdo vakt, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme.

4. Vendimi nr.256, datë 13.6.1994 i Këshillit të Ministrave “Për rritjen e normës së trajtimit ushqimor të kompanisë operative në Gardën e Republikës”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Komandanti i Gardës së Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha